Rezultatet e anketimit japin shifrën prej **5203** banorëve (2550 – **49.00%** meshkuj dhe 2653 – **51.00%** femra) të përfaqësuara në 939 familje. Pjesëmarrja në përqindje sipas grupmoshave është prezantuar në tabelën vijuese :

Mosha 0 – 5 vj.	Mosha 6 – 14vj.	Mosha 15 – 18vj.	Mosha 19 – 25vj.	Mosha 26 – 65vj.	Mosha Mbi 65vj.	Gjithësejt
452	**881**	**390**	**653**	**2495**	**332**	**5203**
8.69 %	16.93 %	7.50 %	12.55 %	47.95 %	6.38 %	100 %

Prandaj, nga kjo del edhe mesatarja e anëtarve për familje:

5203:958 = 5 anëtar/1F

Duke marrë parasysh numrin aktual të fondit banesor (sipas anketimit) rreth **845** (**807** shtëpi individuale banuese dhe afarist-banuese si dhe **38** banesa) dhe numrin e **958** familjeve të prezentuara në anketim fitojmë faktin se rreth (7**.5**%) apo **75** familje me rreth **400** anëtar jetojnë në diasporë kurse në Mitrovicë kanë qëndrim dhe shfrytëzim sezonal. Inkorporimi i tyre në numrin total të banorëve të **ILIRIDËS** jep shifrën prej rreth **5600** banorëve.

Nga mumri i përgjithshëm i popullsisë së evidentuar me anketim, në **54.85 Ha** sipërfaqe sa ka Ilirida, dendësia mesatare e popullatës do sillet rreth **95 banorë/Ha**.

Duke u bazuar në numrin prej **881** nxënësve që vijojnë mësimet në shkollën fillore, që korrespondonë me grupmoshën 6-14vj. do na paraqet pjesëmarrje prej 17.00 % në totalin e banorëve.

Zona Urbane Ilirida shtrihet, gjithnjë sipas PZHU-së, në zonë me koeficientë ndërtimi prej 1,2; 2,0 dhe 3,0. Prandaj i takon zonës së përzier me dendësi të mesme banimi.

Ky parametër < 100 ban/ha, nuk paraqet arsyeshmëri në aspektin ekonomik nga pikëvështrimi i vendosjes dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës komunale mbitokësore dhe nëntokësore.

Pikënisje për parashikimin e ardhshëm të popullsisë së ILIRIDËS, është numri prej 5600 banorëve, parametrat vjetor të rritjes prej 1.03, sipas PZHK dhe PZHU, si dhe trendit të paraparë dhe planifikuar të dendësimit të zonës së Iliridës dhe akseve kryesore rrugore. Varianti i përllogarisë me rritje vjetore prej 1.03 na jep shifrën prej afër 8470 – 8500 banor për ZU Ilirida, gjerë në vitin 2025.

Tabela e parashikimit të popullatës së Iliridës

VITI	2011	2015	2020	2025
Sipas anketimit	**5600**	**6302**	**7306**	**8470**

Hapësira urbane Ilirida ka shënuar shtim të popullatës në dy dekadat e fundit si rezultat i migrimit të popullatës fshat-qytet; migrimit të popullatës veri-jug; shtimit natyror të popullatës; bizneset e ndërtimit etj. Numrit të popullatës rezidente të ILIRIDËS do ti shtohet edhe popullata jorezidente e diasporës (sezonale) pasi i përkasin kategorisë së qytetarve që në masë të konsideruar paraqiten në cilësi të blerësve të hapësirave banesore në Iliridë.

Bazuar në referimet e mësipërme rreth popullatës aktuale të Iliridës (viti 2011) një numër i rrumbullakësuar prej 5600 banorëve duket më reali, kurse numri i parashikuar për vitin 2025 në bazë të varianteve përllogaritëse del se do të ishte rreth 8470 - 8500 banorë. Ka indikacione se numri i banorve në periudhen e ardhshme 2-3 vjeçare ta tejkalojë parashikimin e vitit 2015 nëse marrim parasysh kapacitetet momentale të ndërtimit dhe kapacitetet e protokoleve të lejuara për objektet afariste- banesore të mesme dhe të larta.

II.5. Ekonomia

5.1 Punësimi

Numri i të punësuarëve nga popullata rezidente e zonës urbane Ilirida sipas rezultateve të anketimit është:

Punëdhënësit	**Numri i të punësuarve**		
Vendet e punës	**Meshkuj**	**Femra**	**Gjithësejt**
Sektori publik – shtetëror	290	167	457
Sektori privat	493	111	604
Të punësuar gjithsejt :	783	278	1061

S**ektori publik - shtetëror** përfshin të punësuarit në sektorët: Miniera e Trepçës, Administrata Komunale, Arsimi, Shëndetësia, Policia, Legjislacioni, Ndërmarrjet regjionale (Ujësjellësi, Uniteti, PTK, agjencioni pyjor).

Sektori privat përfshin të punësuarit në veprimtaritë e ndryshme private, si pronarë të bizneseve të ndryshme tregtare - shërbyese. Në total 80.00 % përbëjnë të punësuarit nga popullata rezidente e Mitrovicës, 13.50% nga rrethinat, si dhe 6.50 % të punësuar që gravitojnë nga zonat tjera.

Anketimet rezultojnë se Ilirida disponon me 3148 banorë të grupmoshave të afta për punë. Prandaj nga kjo del se numri i të papunëve - k**uota e papunësisë sillet rreth 66 %.**

> Kuota shumë e lartë e papunësisë pretendon të jetë ndër problemet kryesore të Iliridës dhe një sfidë reale e qëndrueshmërisë dhe zhvillimit ekonomik. Sektori publik – shtetëror nuk ofron mundësi të reja reale të punësimit dhe zvogëlimit të kuotës së papunësisë, prandaj alternativa e vetme mbetet inkurajimi i sektorit privat, inkurajimi i resurseve që ngrisin aftësitë profesionale, aftësitë e biznesit, tregtisë dhe zanatit.

5.2 Degët e ekonomisë

Ndërmarrjet prodhuese - Potenciali kryesor i sektorit prodhues qëndron jashtë kufijve të ZU Ilirida. Në situatën momentale ky sektor është shumë i pa zhvilluar, kurse sipërfaqet me infrastrukturë adekuate pothuajse janë të papërdorshme.

Duke pasur parasysh këtë fakt qëndrueshmëria ekonomike e Zonës Urbane Ilirida është i orientuar drejtë tregëtisë dhe veprimtarive shërbyese, që përmbajnë në vete një potencial të konsiderueshëm.

Tregtia - karakterizohet nga shitore të vogla, të cilat shesin kryesisht gjësende të importuara. Ky sektor për momentin nuk ka kapacitete për zgjerimin e aktiviteteve pasi që hapësira dhe kushtet për tregti të kësaj natyre mungojnë. Mundësitë për ndonjë zonë të përbashkët tregtare, për shkak të afërsisë me zonat tjera, si Qendrën, Zhabarin apo edhe Bajrin, duhet kërkuar me ngritjen eventuale të zonës së lirë tregtare të paraparë sipas planeve zhvillimore jashtë kufijve të Zonës, në qytet ku do të fitonte impuls të ri zhvillimi.

Sipërfaqet më të vogla për tregti dhe zanate mund të zhvillohen nga potencialet ekzistuese, nëse mund të zgjidhet çështja e pronësisë.

Shërbimet - Sektori i shërbimeve është sektor i domosdoshëm për ofrimin e përkrahjes dhe zhvillimin e ndërmarrjeve tjera, mirëpo struktura ekzistuese e veprimtarive shërbyese në Iliridë ndihmon shumë pak zhvillimin ekonomik.



Hartografika 10: Kapacitetet ekonomike

II.6. Banimi

6.1 Terrenet e banimit dhe zonat e përziera

Në terrenet e banimit përfshihen njësitë urbane të banimit dhe rrugët e mbrendshme midis tyre. Pjesë përbërse e terreneve të banimit janë edhe parcelat e çerdheve - kopshteve, shkollave fillore dhe shërbimeve të përditshme tregtare dhe komunale .

Në hapësirën urbane të Iliridës, terrenet e banimit nuk kanë ndarje të qartë në bazë të etazhitetit dhe karakterit të objekteve banuese pasi në pjesët e dominuara me objekte të larta ndërhyjnë edhe objektet e ulëta dhe anasjelltas në pjesët e dominuara me objekte të ulëta me banim individual, ndërhyjne objektet e larta të banimit kolektiv.

Sipas Planit Zhvillimor Urban, hapësira urbane Ilirida, mund të dendësohet edhe më tutje mbi bazën e rrjetit të infrastrukturës ekzistuese rrugore përgjatë akseve kryesore. Hapësirat e lira ndërtimore mund të ndërtohen dhe dendësohen[1] duke shfrytëzuar infrastrukturën ekzistuese.

Zonat e përziera i shërbejnë kryesisht banimit, por lejojnë edhe punëtori me më pak ose fare pak zhurmë dhe shtrihen kryesisht në zonat përgjatë akseve kryesore rrugore. Shfrytëzimet janë si vijon:

Banim
Institucione shkollore dhe institucione shëndetësore
Objekte administrative
Institucione kulturore, religjioze dhe sociale
Tregti dhe shërbime
Gastronomi, zanate dhe punëtori të vogla.

1 Sipas PZhU-së (sipërfaqe më të lartë të shfrytëzimit të parcelave, numër më i lartë i kateve).



Hartografika 11: Shtrirja dhe destinimi i objekteve

6.2 Fondi banesor

Hapësira e përkufizuar urbane e Iliridës gjerë në vitin 1999 para ndodhjes së luftës në pjesën dërmuese të teritorit të saj dominohej nga objektet me destinim banim individual dhe afarist – banimor.

Në dhjetëvjeçarin e pas luftës disa zona – me destinim objekte me banim individual gjatë rindërtimit të tyre pësuan ngritje etazhore, kurse fondi banesorë dhe objektet me banim kolektiv u zhvilluan me ritëm të hovshëm si shkak i ndodhjes së **'fenomenit'** [2] **.**

[2] Periudha e emergjencës; migrimi i popullatës fshat – qytet; veri-jug; ndërtimet pa leje dhe me leje; tejkalimet e lejeve; biznesi i ndërtimit; interesimi i qytetarve të diasporës për të poseduar banesë në qytet, etj.



Hartografika 12: Etazhiteti i objekteve

Bazuar në punët e anketimit dhe inçizimit të terrenit për kategoritë e objekteve që ndërlidhen me çështje të banimit në hapësirën urbane të Iliridës shtrihen:

Nr. i Objekteve	Karakteri urban i objekteve	Tipi i objekteve	Etazhiteti
754	Banimi Individual	Banimor	P+0 deri P+3+Nk
53	Banimi Individual	Banimor - Afarist	P+0 deri P+3+Nk
28	Banimi Kolektiv	Banimor	i mesëm dhe i lartë
10	Banimi Kolektiv	Banimor - Afarist	i mesëm dhe i lartë

Numri i tërësishëm i fondit banesor është i prezantuar edhe sipas sektorëve të anketimit në tabelën vijuese.

ILIRIDA SEKTORËT	Objekte banimi individual	Objekte banimi individual afariste-banimore	Objekte Banimi kolektiv	Objekte Banimi kolektiv afariste-banimore
SEKTORI 1	47	4	0	1
SEKTORI 2	35	4	3	0
SEKTORI 3	23	3	3	0
SEKTORI 4	18	2	1	0
SEKTORI 5	106	1	6	0
SEKTORI 6	23	5	4	0
SEKTORI 7	24	0	0	0
SEKTORI 8	79	1	1	1
SEKTORI 9	58	6	2	0
SEKTORI 10	1	1	0	0
SEKTORI 11	18	0	0	0
SEKTORI 12	26	0	0	0
SEKTORI 13	4	4	0	0
SEKTORI 14	41	0	3	0
SEKTORI 15	13	2	0	2
SEKTORI 16	14	2	0	1
SEKTORI 17	25	6	1	5
SEKTORI 18	29	5	2	0
SEKTORI 19	28	5	0	0
SEKTORI 20	27	0	2	0
SEKTORI 21	115	2	0	0
SEKTORI 22	0	0	0	0
GJITHËSEJT	**754**	**53**	**28**	**10**

Fondi i banesave - periudha kohore deri në vitin 1999

Gjatë periudhës kohore deri në vitin 1999, ka Objekte të Banimit kolektiv në zonën perëndimore buzë lumit Lushta me kapacitetet prej afër 180 njisi banesore prej 2-4 dhomëshe.

Fondi i banesave - periudha kohore 2000 - 2010

Periudha kohore	Numri i objekteve P + 4 deri P + 6	Numri i objekteve P+ 7 deri P + 11
Periudha deri - 1999	6 objekte	0 objekte
Periudha 2000 - 2010	13 objekte	9 objekte

Në vitin 1989 mesatarja e sipërfaqes së banimit në rang qyteti ishte 13 m² për kokë banori dhe kjo mesatare pretendon të rritet në të ardhmen duke ndikuar direkt në rritjen e nevojës për sipërfaqe banimi.

Nëse i referohemi PzhU-së dhe të dhënave të sipërme përkitazi me hapësirat e banimit duhet të sqarohen dy çështje:

A ka nevojë për hapësira të reja për banim?
Si të veprohet me hapësirat ekzistuese të banimit me qëllim që t'i përshtaten nevojave të së ardhmes?

6.3 Gjendja aktuale

Objektet banesore kolektive thuaja se që nga ndërtimi i tyre në vitet 80 ta nuk janë mirëmbajtur fare. Posaçërisht hapësirat e përbashkëta, si: komunikimi (shkallët dhe liftat), erëmbrojtësat, bodrumet, instalimet elektrike, ujësjellësi e kanalizimi, etj. Fasadat kanë pasur një të mirë se janë me tulla fasade dhe u është mundësuar një ruajtje e gjendjes relativisht të mirë.

Rrethinat e këtyre blloqeve të banimit ofrojnë shumë pak kualitete pushimi, veçanërisht vendet për lojëra të fëmijëve mungojnë.

Objektet ekzistuese banesore mund të rinovohen në nivelin e kënaqshëm me iniciativë të vetë banorëve që posedojnë banesat, si dhe në bashkëpunim dhe ndihmë të plotë nga institucionet gjegjëse të komunës.



Hartografika 13: Gjendja e objekteve

6.4 Mbindërtimet

Situata e pasluftës dhe nevojat e mëdha për strehim - banim si dhe pamundësia e organeve kompetente për parandalimin e tyre me kohë ishin shkaktarët e nismës dhe realizimit të mbindërtimeve. Në ZU Ilirida, ky fenomen, sipas anketimeve nga terreni tregon për gjithsejtë 2 raste mbindërtimi, kështu që nuk mund ta quajmë si n jë fenomen që ishte në zonat tjera urbane.

Prandaj, realisht nuk kemi ndikim të madh në ndryshimin i marrëdhënieve ekzistuese urbane të zonës në kuptimin e rritjes së koeficientëve të shfrytëzueshmërisë, dendësisë së banimit dhe nevojave për parkim.

Trajtimi i mbindërtimeve nuk do të bëhet veç e veç por duhet të bëhet në tërësinë e ndërtesës ose bllokut të përbërë nga dy a më shumë ndërtesa me respektim të trajtimit të paanshëm dhe të barabartë. Gjithashtu pjesë integrale e planit rregullativ urban do të jenë dispozitat për trajtimin e mbindërtimeve të cilat do ti përcaktojnë kushtet, mënyrat dhe procedurat për trajtimin (lejimin, legalizimin apo rrënimin) e mbindërtimeve.

II.7. Infrastruktura sociale dhe kulturore

7.1 Infrastruktura sociale – Arsimi [3]

Sipas PZhU të miratuar në maj të vitit 2009 ka mungesë të hapësirave për mësim, të paisjeve të punës dhe teknologjisë komjuterike, të laboratorëve dhe bibliotekave. Gjithashtu ka mungesë të personelit të kualifikuar. Të dhënat në tabelat vijuese janë nga kontaktet me institucionet gjegjëse në vitin 2011.

- Institucionet parashkollore në lagjen "ILIRIDA"

Normat elementare parashohin një mungesë totale në këtë aspekt. Lagja nuk disponon me as edhe një çerdhe apo kopsht të fëmijëve.

[3] Gjendja nga viti shkollor 2011/12

- Arsimi fillor dhe i mesëm i ulët në lagjen "ILIRIDA"

Shkolla fillore dhe e mesme e ulët:			"Abdullah Shabani"
Nr. i nxënësve			1043
Nr. i mësonjëtoreve (klasave)			25
Dhoma për nevoja të veçanta			0
Kabinete			1
Nr. i dhomave për parafillor			1
Nr. i dhomave për mësimdhënës			1
Nr. i dhomave për administratë			3
Dhoma e muzikës			0
Bibliotekë			1
Kuzhinë			0
Salla e sporteve			0
Depo			0
Fushë e sportit			1
Nr. i punëtorive			0
	Nr. i toaleteve	Hendikepuar	0
		Femra	4
		Meshkuj	5
		Mësimdhënës	1
Sipërfaqja e objektit (m²)			802
Sipërfaqja e oborrit (m²)			7221
Hapësira e korridorit (m²)			
Puna me ndërrime			2 ndërresa
Nxënës / ndërrim			520
Nr. i paraleleve			33
Nxënës / klasë			32
Sip. e obj. (m²) / nxënës			0.76
Sip. e lire (m²) / nxënës			0
	Personeli mësimdhënës	Të kualifikuar	44
		Të pakualifikuar	0
		Femra	36
		Meshkuj	8
		Gjithsej	44
Nevoj për rekonstruktim /rehabilitim			Po

Rekapitulim:

Nr.	Institucioni arsimor	Numri i nxënësve	Numri i personelit
1	Parashkollor	0	0
2	Arsimi fillor dhe i mesëm i ulët	1043	44
	Gjithësejt :	**1043**	**44**

Nga referencat e sipërme krijohet një pasqyrë e qartë lidhur me situatën ekzistuese në arsimin fillore dhe të mesëm të ulët në hapësirën urbane 'Ilirida'. Krahas punës në dy ndërrime, konkludojmë se edhe sipërfaqja në dispozicion për nxënës (si për nga sipërfaqja bruto e objektit ashtu edhe të hapësirës përreth) është ende shumë e vogël[4].

Në shkollën fillore Abdullah Shabani është vepruar në drejtim të zgjerimit të hapësirave ekzistuese shkollore. Hapësirat ekzistuese përreth këtyre shkollës nuk japin ndoj perspektivë rreth mundësive të zgjerimit, megjithatë duhet kërkuar zgjidhje të reja.

4 Normat gjermane sipas Neufert-it, botimi 2005 janë: sipërfaqja bruto për një nxënës = 13m², hapësira e arealit shkollor për një nxënës = 25 m².

7.2 Infrastruktura sociale - Shëndetësia

- Entet shëndetësore

Në zonën urbane të Iliridës, nga entet shëndetësore janë dy objekte ekzistuese:

Shtëpia e shëndetit e cila ofron shërbime ambulatore pë banorët e lagjes por edhe të tjerë. Intervenimet stacionare nga ky vit (2011), janë të mundshme në segmentin spitalor të pozicionuar në hapësirën e ish kazermës e cila me konfiguracionin e terrenit, gjelbërimin dhe madhësinë e arealit ofron kushte optimale.

Objekti shëndetësorë për trajtimin e pacientëve me probleme mentale.
Areali përreth objekteve shëndetësore duket me tejngarkesa, me theks në fushën e zhvillimit normal të komunikacionit, ku kemi vërtetë një kaos me automjete që nuk kanë as edhe një parking.

> A janë këto kapacitete shëndetësore të mjaftueshme duhet të precizohet nga punëtoria pasuese me të gjitha strukturat relevante.

- Entet për përkujdesje

Në ZU Ilirida ka një objekt për punë dhe përkujdesje sociale. Mirëpo destinimi i objekti është ndërruar në stacion të Policisë së Kosovës - stacioni i Mitrovicës.

7.3 Infrastruktura kulturore, trashëgimore dhe fetare

- Institucionet kulturore e zbavitëse

Në ZU Ilirida nuk ka ndonjë objekt nga Institucionet kulturore e zbavitëse.

- Objektet e trashëgimisë kulturore

Fakti që hapësira urbane e Iliridës është relativisht e re në aspektin kohor të urbanizimit, edhe nuk ka objekte të cilat janë nën mbrojtjen institucionale, as edhe objekte të inventarizuara.

- Objektet fetare dhe të kultit

Në zonën urbane të Iliridës nuk ka objekte fetare dhe të kultit.

7.4 Infrastruktura e objekteve të sigurisë publike

- Objektet policore

Në ZU të Iliridës, nuk ka objekt ekzistues që enkas është i punuar për destinimin – stacion policor, mirëpo është bërë shndërrimi i objekti ekzistues për përkujdesje sociale në Stacion Policie.



Hartografika14: Infrastruktura sociale dhe publike zonën urbane Ilirida

II.8. Infrastruktura teknike

Pjesa dërmuese e Iliridës, e ndërtuar në bazë të planeve është mjaft mirë e përfshirë me infrastrukturë, por koncepti i planit rregullues urban do të ketë bazë të mjaftueshme të kërkoi rivlerësimin e infrastrukturës ekzistuese, zvogëlimin e humbjeve në rrjete dhe ngritjen e vazhdueshme të kualitetit furnizues të tyre.

8.1 Energjia elektrike

Mitrovica dhe "ILIRIDA" si pjesë integrale e saj në fushën elektroenergjetike kanë gjendje të pa qëndrueshme pasi ka ndërprerje të shpeshta të rrymës elektrike për arsye të kapaciteteve të kufizuara, humbjeve dhe defekteve në rrjet.

Hapësira urbane "ILIRIDA" në aspektin elektroenergjetik të planifikimit zhvillimor urban të qytetit, është planifikuar dhe paraparë qysh më herët. Furnizimi i Iliridës bëhet nga Mitrovica 2 (në Fidanishte), 35/10kV, ku kemi mbingarkim dhe në projektet e ardhme është paraparë kalimi në nivelin 110/20 (10) kV.

Këto TS janë instaluar për tension 10kV, pa mundësi të eksploatimit në tension 20kV.

Linjat furnizuese të TS 10/0.4kV janë të kombinuara me kabllo ajrore dhe kabllo nëntokësore 10kV, prandaj duke pasur parasysh edhe anën funksionale të infrastrukturës rrugore, mund ti kualifikojmë si shëmti urbane.



Hartografika 15: Infrastruktura teknike - Energjia elektrike

8.2 Rrjeti i ujësjellësit dhe furnizimi me ujë të pijshëm

Furnizimi më ujë të pijshëm duhet të përmirësohet konform rritjes së popullsisë, zhvillimit ekonomik dhe ngritjes së standardit jetësor, me implementimin e planit ekzistues për rritjen e kapaciteteve të fabrikës për përpunimin e ujit ose ndarjes së re të kapaciteteve ekzistuese.

Në saje të investimeve të konsiderueshme ekziston një rrjet funksional i furnizimit me ujë të pijes por i mbingarkuar si shkak i segmenteve të vjetruara të rrjetit furnizues, humbjeve në rrjet dhe kyçjeve ilegale të objekteve banuese.

Sipërfaqja e tërësishme e hapësirës urbane Ilirida, që është ~ 54.85 Ha, kurse numri i popullatës sipas anketës së bërë dhe profilit urban të Iliridës konsiderohet:

- rreth 5203 banorë rezident (banorë të përhershëm),
- rreth 400 banorë sezonal dhe
- rreth 69 të punësuar apo ushtrues të bisneseve private, që konvergjojnë nga zonat tjera.

prandaj përvetësojmë shifrën prej 5600 banorëve / shfrytëzuesve.

Nr.	Pozicionet	Koeficientët	Totali
1	Norma e harxhimit të ujit për një banor	**N = 200 l/b/ditë**	
2	Koeficienti i jonjëtrajtshmërisë	**K = 2.0**	
3	Sasia e nevojshme për furnizim	**Qmes = 46.29 L /s**	
4	Humbjet në rrjetë merren gjithsejt 20% e prurjeve të përgjithshme	**H = 11.57 L / s**	
	Gjithësejt :	**57.86 L /s**	

Duke marrë në konsideratë harxhimet e mëdha të ujit për pije preferohet që për ujitjen e sipërfaqeve të mëdha gjelbëruese, për larjen e rrugëve dhe trotuareve, për shërbimet e autolarjeve të hulumtohen mundësitë e shfrytëzimit të ujërave nëntokësore. Nevojat për ujitjen e sipërfaqeve gjelbëruese janë si vijon:

1. Sipërfaqet dekorative të qytetit.....14 -18 l / m2
2. Sipërfaqet e mbjella me lule .....14 -18 l / m2
3. Larja e shesheve gjatë ditëve të nxehta..... 2 l / m2
4. Drunjët e porsambjellë në tre vitet e para.....18 -27 l / një dru duke marrë për bazë nevojat 6 -10 ujitje në ditë.

Konkludim :

Në bazë të të dhënave të lartëcekura konkludojmë se sasia e nevojshme për të furnizuar me ujë të pijes hapësirën urbane 'Ilirida ' është:

Qmes/ditë = ...(l/s),

Diametri i gypave Ø450 mm dhe Ø200 i plotëson kushtet e nevojshme për furnizim me ujë por duhet të ndërrohen me gypa plastike (PE ose te ngjashëm) duke e përfshirë edhe ndryshimin e pusetave si dhe pjesëve fazonike.

Të gjitha projektet e planifikimit të rrjetit dhe realizimit të tij për hapësirën urbane të Iliridë duhet të jenë pjesë integrale e planit rregullues urban në kapitullin e ardhshëm të zgjidhjes konceptuale.



Hartografika 16: Rrjeti i furnizimit me ujë të pijshëm

8.3 Largimi i ujërave të ndotura (fekale dhe atmosferike)

Zona urbane e Iliridësës është kryesisht e mbuluar me rrjet të kanalizimit fekal dhe ujërave atmosferik, mirëpo shkarkimi i tyre bëhet në lum të hapur. Ndërtimi dhe mirëmbajtja e një sistemi efikas për mbledhjen e ujërave të zeza si dhe ndërtimi i një impianti[5] për pastrimin e tyre është parakusht i rëndësishëm për ngritjen e standardit jetësor.

Sipas shënimeve të marra nga kompania "Ujesjëllësi Regjional", gati e tërë hapësira e përkufizuar e Iliridës, është e përfshirë me rrjetin e kanalizimit fekal, por ka edhe segmente të rrjetit të kanalizimit fekal të kombinuar d.m.th. ujërat fekale janë të përziera me ujërat atmosferike. Rrjeti për largimin e ujërave fekale është i punuar me gypa të beton armesë me diametra të ndryshëm, kurse një numër i pusetave janë të dëmtuara dhe u mungojnë kapakët e gizës.

5 Sipas PZHU-së është paraparë që në pikën më të ulët të qytetit, ku bashkohen Ibri dhe Sitnica në një sipërfaqe prej ~ 2Ha të vendoset impianti për trajtimin e ujërave të zeza.



Hartografika 17: Rrjeti i largimit të ujërave të zeza

8.4 Ngrohja / Furnizimi me ngrohje

Pasi sistemi i ngrohjes qëndrore nuk ka fare shtrirje në pjesën jugore të qytetit dmth. edhe në ZU të Iliridës, rezulton se çështja e ngrohjes përcillet me probleme të ndryshme pasi shumica e shtëpive dhe banesave përdorin ngrohjet alternative si: drurin, thëngjillin, gazin, rrymën, etj. Trajtimi i kësaj problematike duhet të ketë çasje të mirëfilltë dhe serioze. Shtrrirja e rrjetit të ngrohjes në lagje do të kishte efekte shumë pozitive, si në aspektin e shpenzimeve, poashtu edhe të kursimeve, si dhe do ti shmangë mundësitë e dëmtimeve të rrjeteve të infrastrukturës.

Rekomandimet:

- Të bëhet shtrirrja graduale e rrjetit të ngrohjes fillimisht në akset kryesore rrugore e më pas edhe në akset tjera.
- Të shqyrtohet mundësia e ndërtimit të ngrohtores me kapacitete të mjaftueshme.

8.5 Telekomunikimet

Hapësira urbane e Iliridës, në aspektin telekomunikativ mbulohet me shërbimet e tre kompanive përkatëse PTK, IPKO dhe Kujtesa.

Të gjitha ofrojnë shërbimet e telefonisë, TV dhe internetit. Sipas të dhënave të tyre rrjeti telekomunikativ është i realizuar me kabllot nëntokësore të shtrira përgjatë kanaleve kabllore, si dhe në shtylla druri, metali, etj. Aktualisht numri i mundshëm i kyçjeve telefonike i përmbush kërkesat e Iliridës. Momentalisht përdoren lidhjet radiodifuzive por është duke u punuar në rrjetin e ri të kabllimit optik me qëllim të rritjes së kualitetit të telefonisë (telefonia digjitale).

Konkludim – Lidhjet kabllovike të shumicës së linjave është bërë prej një objekti në objekt tjetër, lidhjet e zonave janë bërë duke kaluar rrugët si rrjetë merimange, duke shëmtuar hapësirën e zonës Urbane, prandaj obligohen të bëjnë zgjidhje me shtrirje të kabllove nëntokësore.

Instalimet ekzistuese të infrastrukturës teknike, në të shumtën e rasteve janë realtivisht të amortizuara, disa prej tyre të pa instaluara, kurse disa janë në proces e sipër sipas planeve zhvillimore të organizatave gjegjëse. Ndërtimet e reja paraqesin imperativ për instalime të reja të infrastrukturës teknike duke pasur parasysh ruajtjen e resurseve ekzistuese të vendit dhe ruajtjen e ambientit.

Instalimet e ujësjellësit-Rivlersimi dhe plotësimi i sistemit ekzistues

Instalimet e kanalizimit-Rivlersimi dhe plotësimi i sistemit ekzistues

Akumulimet e ujërave atmosferik – Punimi i kolektorëve dhe vendosja e ujëmbledhësve

Instalimet e ngrohjes - Programi i ruajtjes së energjisë dhe ambientit

Instalimet e rrjetit kabllovik – Largimi i të gjitha antenave satelitore

Instalimet e internetit – sistem qendror i instalimeve

Ndriçimi publik - funksional, dekorativ dhe reprezentativ

II.9 Infrastruktura rrugore dhe komunikacioni

9.1 Rrjeti rrugor

Rrugët kryesore të zonës urbane Ilirida, janë të asfaltuara dhe mirëmbahen deri diku, një numër i madh i rrugëve lidhëse dhe rrugicave janë të shtruara me kubëza betoni. Rrjeti i rrugëve mund të themi se aërsisht është i kompletuar. Ura si vij lidhëse e dy Zonave – Iliridës me Urën e Gjakut është në një gjendje relativisht të mirë.



Hartografika 18: Rrjeti i rrugëve kryesore dhe lidhja e tyre

9.2 Trafiku publik

Mobiliteti, si edhe në brendinë e qytetit, është shumë i hendikepuar pasi mungon sistemi i transportit urban. Në vend të transportit urban ka numër të madh të auto-taksive, që dmth. se banorët e qytetit janë të varur nga transporti individual. Një vështirësi shtesë këtu paraqet edhe rrjeti i rrugëve dhe shtigjeve të cilat nuk janë të përshtatshme për këmbësorë dhe biçiklista.

9.3 Qarkullimi i këmbësorëve, biçiklistëve dhe të hendikepuarve

Rrjeti i komunikacionit të këmbësorëve dhe biçiklistëve në ZU Ilirida, pothuajse nuk ekziston fare, edhe pse është element shumë i rëndësishëm i mobilitetit urban.

Këmbësorët përbëjnë numrin më të madh të pjesëmarrësve në komunikacion me vlerësimet 60-80% të pjesëmarrësve të tërësishëm. Kjo dmth. se të gjitha rrugët dhe rrugicat shfrytëzohen nga këmbësorët, si dhe në një përqindje edhe nga biçiklistët. Edhe vajtja-ardhja në shkollë bëhet në masë të madhe në këmbë.

Pastaj edhe nevojat imediate të të hendikepuarëve në proceset e sotme të planifikimit të sistemit të rrugëve, duhet trajtuar seriozisht. Gjendja aktuale nuk është aspak e përshtatshme, prandaj duhet kërkuar përmirësime dhe plotësime.

9.4 Vendparkingjet për automjete

Çështja e vendparkingjeve, është shumë e rëndësishme dhe çështja më e diskutueshme gjatë procesit të planifikimit urban. Në ZU Ilirida, pothuajse nuk ka fare trajtim për vendparkingje publike, për vijat dhe që frekuentohen nga nevojat ditore të banorëve rezident dhe atyre nga tjerat zona.

> Koncepti i zgjidhjes urbano – arkitektonike si kapitull pasues do të ofroi skenarët e zgjidhjes sa më të favorshme të infrastrukturës rrugore duke trajtuar të gjitha çështjet të cilat ndërlidhen me të si : trafiku publik, vendparkingjet, qarkullimin e këmbësorëve, biciklistëve dhe të hendikepuarve.

II.10 Peisazhi, mjedisi, hapësirat e lira

10.1 Hapësirat përreth lumit Lushta

Brigjet e lumit Lushta, janë hapësira të rëndësishme për pushim dhe rekreacion të Iliridës, edhe pse shtrihen në zonën perëndimore. Mirëpo mirëmbajtja jo adekuate si dhe shfrytëzimi i këtij thesari natyror si kolektor-mbledhës i ujërave fekale paraqet rrezikshmëri për ambientin dhe njerëzit.

Pasi që edhe ashtu janë degraduar disa parametra elementar ambiental, duhet bërë çmos që të funksionalizohet sadopak shfrytëzimi i mundshëm i brigjeve nga banorët dhe të tjerët.

> Këto elemente pretendojnë të jenë pjesë e konceptit përfundimtar të zgjidhjes rregulluese urbane, prandaj këto hapësira duhet siguruar në planin rregullativ dhe të mos lejohet ndërtimi në to.

10.2 Hapësirat publike – park, gjelbrim dhe shesh

Ilirida ka në dispozicion shfrytëzimin e parkut "Xhevë dhe Fehmi Lladrovci", që deridiku ka plotësuar një boshllëk të madh të hapësirave gjelbëruese në kuadër të Zonës Urbane, edhe pse frekuentimi i tij ditor bëhet edhe nga zonat tjera Urbane. Hapësira tjera gjelbërimi pothuajse nuk ka zona Urbane, shkaku i thjeshtë mostrajtimi i tyre.

Përjashtim mund të bën gjelbërimi i lartë përgjatë rrugës ndarëse me ZU Fidanishte.



Hartografika 19: Hapësirat publike- park, gjelbërim dhe shesh

10.3 Hapësirat e lojërave për fëmijë

Në ZU Ilirida thuajse, vlerësimet e përgjithshme favorizojnë mungesën e hapësirave të lojërave për fëmijë. Këtu kemi parkun "Xhevë dhe Fehmi Lladrovci", i cili shfrytëzohet edhe si hapësirë për lojë dhe rekreacion të fëmijve.

10.4 Hapësirat sportive

Kualiteti dhe oferta e hapësirave për sport dhe rekreacion, duhet të trajtohet në rang qyteti dhe si e tillë kualifikohet si jo e kënaqshme, prandaj në këtë kontekst edhe ZU Ilirida, mbetet për të dëshiruar. Një pjesë e aktiviteteve sportive zhvillohet në zonat kufizuese, atë të Fidanishtes dhe Zhabarit.

Një vij, edhe pse segment i shkurtër i mundësisë së qasjes, paraqet lumi Lushta, ku mund të ketë shteg rekreimi.

Hapësirat sportive duhet plotësuar patjetër me infrastrukturë përcjellëse, si rrugë, parkingje, etj.

II.11 Ambienti (toka, uji, ajri)

11.1 Problematika e ndotjeve industriale (toka, uji, ajri)

Impiantet prodhuese të kompleksit industrial Trepça përgjatë dekadave të tëra kanë ndotur ajrin, ujin dhe tokën jo vetëm të qytetit dhe rrethinës së afërt të Mitrovicës por edhe regjionit të gjerë përreth. Kjo ndotje e ajrit, ujit dhe tokës është regjistruar, të dhënat janë grumbulluar dhe janë analizuar në mënyrë permanente por efektet pozitive për mbrojtje asnjëherë nuk kanë qenë të kënaqshme.

Në kontekst të analizave, hulumtimeve dhe studimeve pas lufte edhe OBSH (Organizata Botërore për Shëndetësi), ka bërë një studim që ka rezultuar se ekziston një ndotje e konsideruar e ambientit me plumb dhe metale tjera nga deponitë e mbeturinave industriale.

- Toka - Ndotja e tokës bëhet në mënyrë direkte dhe indirekte.

  Ilirida si hapësirë urbane paraqet një zonë me shkallë relativisht më të ulët të ndotjes, megjithatë edhe Ilirida si hapësirë urbane iu është nënshtruar poashtu mënyrës indirekte të ndotjes. Ndotja e tokës në mënyrë direkte bëhet nga vetë prania e deponive dhe djerrinave. Shtrohet një nevoj e punimit të disa parametrave se si duhet vepruar me tokat e ndotura gjatë ndërtimit të objekteve të reja dhe duhet tentuar në maksimum zgjerimin e sipërfaqeve gjelbëruese dhe mbjelljen e fidaneve.
- Ajri - Pasiviteti i prodhimtarisë industriale, ka reduktuar mjaft ndotjen e ajrit, mirëpo prapë se prapë, ajri është tepër i ndotur si shkak i deponive të hapura të mbeturinave industriale, pastaj ndotjen e ajrit e rrisin edhe faktorët tjerë si: ngrohja e shtëpive me dru dhe thëngjill, rritja e numrit të automjeteve dhe komunikacioni i dendur. Ndotja e ajrit kryesisht ndodhë nga këto materiale: Pb, Zn, As, Cd, SO2.
- Uji (Ndotja e lumenjëve) - Nëpër zonën urbane Ilirida tangjenton lumi Lushta, i cili në mungesë të impianteve për kullimin e ujërave të zeza, derdhjeve të kanalizimeve, paraqet një burim shtesë të ndotjes së ambientit.

Lumi Lushta, tangjenton kufirin lindor të ZU Ilirida, i cili edhe aktualisht në këtë pjesë shërben si kolektor i ujërave të zeza të cilat derdhen më pastaj edhe në lumin Ibër.

11.2 Prioritetet në lëmin e mbrojtjes së ambientit

Duke pasur parasysh se problematika e ndotjeve industriale (toka, uji, ajri) do të jetë prezente edhe për një kohë të gjatë dhe me qëllim zvogëlimi të ndikimit negativ dhe të mbrojtjes së ambientit sipas planeve hapësinore të qytetit janë caktuar këto prioritete:

- Përgatitja e projekteve për sanimin e deponive
- Vëzhgimi i nivelit të ndotjes së tokës, ujit dhe ajrit
- Programet për eliminimin e koncentrimit të plumbit dhe metaleve tjera
- Programe për trajtimin e ujërave të ndotura dhe ujërave industriale
- Zgjerimi i sipërfaqeve të gjelbërta
- Përdorimi i teknologjive ekologjike
- Implementimi i standardeve të BE-së

II.12. SWOT Analiza dhe përmbledhja e njohurive

12.1 SWOT Analiza

SWOT-Analizat sipas grupfushave tematike hedhin në dritë gjendjen e tanishme dhe tregojnë vështirësitë dhe pengesat për zhvillimet e së ardhmes për hapësirën përkufizuese të Zonës Urbane Ilirida.

SWOT Analiza – Popullsia dhe ekonomia

Përparësitë	Mangësitë - Dobësitë
- Popullata me moshë të re - Fuqia e lirë punëtore - Fuqizimi i ndërrmarjeve të vogla dhe të mesme - Kapacitetet ekzistuese të mjaftueshme për rizhvillim të banimit	- Papunësia e lartë - Buxheti i vogël
Mundësitë - Shanset	**Kërcënimet - Rreziqet**
- Veprimtaritë Kulturore – me objekte adekuate - Ngritja e nivelit ekonomik me krijimin e parakushteve për zhvillim ekonomik - Ngritja e proceseve të reja teknologjike me iniciativa private	- Ndarja e buxheteve - prioritetet - Funksionimi i plotë i një Komune si një tërësi

SWOT Analiza – Infastruktura sociale (Arsimi, Shëndetësia etj)

Përparësitë	Mangësitë - Dobësitë
- Dendësi e banorëve që mundëson numër të nxënësve për të gjitha niveleve të arsimit dhe edukimit - Prania e dy enteve shëndetësore – njëri ambulantor - Prania e një ish qendre për punë sociale	- Hapësirat e pamjaftueshme shkollore për numrin e nxënësve dhe mësimi me ndërrime - Mungesa e pajisjeve teknike dhe laboratorëve - Infrastrukturë e pamjaftueshme shëndetësore
Mundësitë - Shanset	**Kërcënimet - Rreziqet**
- Sigurimi i lokacionit për zgjerimin e shkollës - Sigurimi i lokacioneve të reja për objekte të reja shkollore - Zvogëlim i perimetrit të lëvizjes së nxënësve	- Prania e dukurive negative nëpër shkolla

SWOT Analiza - Shfrytëzimi i tokës ndërtimore, Infrastruktura teknike, rrugore dhe komunikacioni

Përparësitë	Mangësitë - Dobësitë
- Kapacitetet ekzistuese funksionale për banorët rezident - Resurset e ujit – deridiku të mjaftueshme - Sistem funksional i telekomunikimit	- Mosekzistimi i politikës së kontrollit të ndërtimeve në tërë qytetin - Joefikasiteti në parandalimin e plotë të ndërtimeve pa leje në zonat pa infrastrukturë adekuate - Jostabiliteti i rrjetit elektrik, humbjet dhe defektet në rrjet - Jofunksionimi i sistemit të transportit urban - Mungesa e shtigjeve për këmbësor dhe biçikleta - Numri i madh i autotaksive dhe mungesa e hapësirave për sistemim të tyre
Mundësitë - Shanset	**Kërcënimet - Rreziqet**
- Fuqizimi dhe kontrolli më i mirë i shfrytëzimit të tokës - Përmirësimi i infrastrukturës rrugore - Përmirësimi i rrjetit elektrik - Përmirësimi i rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit - Aktivizimi i sistemit të transportit urban - Realizimi i shtigjeve të këmbësorëve dhe biçiklistëve - Realizimi i pikave të parkingjeve publike	- Çështjet e pazgjidhura pronësore - Ndërtimi i shkapërderdhur dhe larg çasjes së mirëfilltë në infrastrukturë - Largimi i pjesërishëm i pakoordinuar i mbeturinave - Hapësirat e pamjaftueshme të parkingjeve publike

SWOT ANALIZA – Peisazhi, hapësirat e lira dhe ambienti

Përparësitë	Mangësitë - Dobësitë
- Hapësirat e lira përgjatë lumit Lushta - Potencialet e sportit dhe rekreacionit	- Shkarkimi i ujërave të zeza në lumin Lushta
Mundësitë - Shanset	**Kërcënimet - Rreziqet**
- Përmirësimi i gjelbërimit dhe mirëmbajtja - Zgjerimi i sipërfaqeve gjelbëruese - Programet për pastrimin e ambientit nga koncentrimi i plumbit dhe metaleve të rënda	- Koncentrimi i lartë i metaleve të rënda në tokë (plumbi, kadmiumi, arseni etj)

12.2 Përmbledhje e njohurive

Përmbledhja e njohurive themelore të fazës së analizës dhe SWOT-it shërben për fokusimin e problemeve akute të Zonës Urbane Ilirida, si dhe për theksimin e fushave të veprimit, skenarëve të zhvillimit dhe përpilimit të planit rregullues urban.

- Prona

Bazuar në referimet e mësipërme dhe dokumentacionet disponuese rreth çështjeve pronësore në hapësirën urbane të Ilirida, problemet kyçe qëndrojnë në joazhuritetin e rregullimit pronësoro-juridik të tyre.

- Populllësia

Hapësira urbane Ilirida, ka shënuar shtim të popullatës në dy dekadat e fundit si rezultat i migrimit të popullatës fshat-qytet; migrimit të popullatës veri-jug; shtimit natyror të popullsisë, etj. Më pastaj numrit të popullsisë rezidente të ILIRIDËS i shtohet edhe popullsia jorezidente (sezonale) – e ardhur, qoftë nga pjesë tjera urbane dhe rurale ose nga diaspora.

Bazuar në referimet e mësipërme rreth popullatës aktuale të Iliridës (viti 2010) duke përfshirë edhe qytetarët jorezident, një numër i përafërt i popullatës prej 5600 banorëve duket më reali, kurse numri i parashikuar për vitin 2025 në bazë të varianteve përllogaritëse del se do të ishte rreth 8470 - 8500 banorë.

- Ekonomia

Sektori prodhues tani për tani është tërësisht pasiv edhe pse potenciali qëndron jashtë kufijve të ZU Ilirida. Pa përfundimin e procesit të privatizimit nuk do të ketë areale të rëndësishme për ndërmarrje prodhuese apo shërbyese.

Tregëtia dominon në sektorin privat dhe karakterizohet me shitore të vogla. Zhvillimi i tregtisë krahas hapësirës së mangët vështirësohet edhe si pasojë e koeficientit të ulët konsumues.

Sektori i shërbimeve është sektor i domosdoshëm për ofrimin e përkrahjes dhe zhvillimin e ndërmarrjeve tjera, mirëpo struktura ekzistuese e veprimtarive shërbyese ndihmon shumë pak zhvillimin ekonomik dhe pothuajse nuk ekziston fare.

- Papunësia dhe fuqia punëtore

Shkalla e lartë e papunësisë paraqet një ndër problemet kryesore për zhvillimin e ardhshëm. Në situatën e tanishme ekonomike kërkohen kryesisht aftësi profesionale që ju mundësohet të punojnë në sektorin privat. Kjo përmban sidomos aftësi në ndërmarrësi, tregëti dhe zanate.

- Banimi

Zhvillimi i hapësirave banuese (fondit banues) nuk bëhet në mënyrë të kontrolluar institucional, pasi përveç zhvillimeve në segmentet mes akseve kryesore rrugore kemi zhvillime edhe në pjesët ku çasja e mirëfilltë në infrastrukturën rrugore dhe teknike mungon.

- Infrastruktura sociale – Arsimi dhe Shëndetësia

Si pasojë e hapësirave të pa mjaftueshme shkollore fëmijët mësojnë në 2 turne. Përveç saj ka edhe vështirësi tjera, pasi pajisjet janë të pamjaftueshme, mungon kuadri i kualifikuar arsimorë, laboratorët dhe bibliotekat.

- Objektet e kultit dhe trashëgimia kulturore

Zona Urbane e Iliridës muk posedon të mira kulturore, mirëpo aspekti i trashëgimisë është një sektor multidimensional, prandaj në situatën momentale politike, kultivimi dhe zhvillimi i mëtejmë i trashëgimisë kulturore paraqet një sfidë të madhe.

- Infrastruktura teknike dhe komunikacioni

Rrjeti i rrugëve brenda zonës ende është i pakompletuar. Vetëm rrugët kryesore janë të asfaltuara, si dhe një shumicë dërmuese e shtruar me kubëza.

Përmirësimet apo edhe zgjerimet në rrjetin ekzistues duhet të shqyrtohen. Gjithashtu duhet ritrajtuar udhëkryqet rreth ngritjes së funksionalitetit të tyre.

Shtigjet për biçiklista nuk ekzistojnë fare, kurse shtigjet për këmbësor nuk janë adekuate gjë që paraqet rrezik për pjesëmarrësit në komunikacion.

Mungesa e një sistemi të transportit urban ndikon që mobiliteti brenda qytetit të jetë shumë i hendikepuar, kurse banorët e qytetit janë të varur nga transporti individual.

Shkarkimi i ujërave të zeza në lum dhe mungesa e përpunimit të tyre si dhe pjesërisht largimi i pakoordinuar i mbeturinave, mund të paraqesin rrezik për shëndetin dhe ambientin.

- Kualiteti jetësorë / Ambienti

Nevoja për sipërfaqe banimi duket të jetë ende e lartë. Një numër i madh i ndërtimeve të vjetra kanë nevojë për sanim.

Kualiteti dhe oferta e hapësirave për sport dhe rekreacion, kërkon përmirësime dhe plotësime. Hapësirat përgjatë lumit Lushta, paraqet një potencial të zonës rekreuse.